

V E N D I M
Nr.332, datë 29.5.2003

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.326, DATË 21.6.1993 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E TRAJTIMIT TË INVALIDËVE TË
LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

“5. Invalidët e luftës gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat e kurimit, që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas të gjitha barnat, sipas recetës së mjekut.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat si më poshtë vijnë:

“5/a. Invalidët e luftës me gjymtime të rënda, në pamundësi të kurimit brenda vendit, të diagnostikohen e kurohen jashtë shtetit, sipas vendimit të komisionit ndërspitalor, që funksionon pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

5/b. Invalidët e luftës të pajisen falas nga Ministria e Shëndetësisë me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse, të përshtatshme për ta.

5/c. Udhëtimi i invalidëve të luftës me mjetet e transportit qytetës, publik bëhet falas, ndërsa me mjetet e transportit ndërqytetës të bëhet duke paguar gjysmën e vlerës së biletës, kundrejt paraqitjes së dëshmisë së invalidit. Për rastet kur këto transporte janë private organet përkatëse, në kontratat me subjektet private, parashikojnë efektet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj pike.

5/ç. Kur invalidi i luftës vdes, komuna ose bashkia i bën nderimet përkatëse dhe përballon shpenzimet e varrimit, duke i dhënë familjes së të ndjerit 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Në shpenzimet e varrimit përfshihen arkivoli, transporti, qëndrimi në morg, ceremonia dhe dreka.

5/d. Organet e qeverisjes vendore trajtojnë me strehim, me përparësi, familjet e konsideruara të pastreha, që në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa shtesa në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”” kanë në përbërje të tyre invalid, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.”.

3. Pas pikës 7, shtohen pikat si më poshtë vijnë:

“7/a Departamenti i veteranëve e invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe dëshmorëve të atdheut, në Ministrinë e Mbrojtjes, ndjek zbatimin e politikave të qeverisë për përkujdesjen ndaj invalidëve të luftës, sipas të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

7/b Deklarimi invalid lufte nga Komisioni i Ekspertizës Mjekoligjore dhe përcaktimi në grupin përkatës konsiderohen të mbyllura.”.

4. Pika 8 ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.”.

5. Ngarkohen ministratë e përmendura më sipër të kryejnë procedurat ose të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano